

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit U. K., nga fshati L., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.600/2016, të datës 21.09.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 24.04.2017, në prezencën e Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të dëmtuarës Z. D. si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

U. K., nga i ati S., e ëma S., e gjinisë S., i lindur me datën... në Gjakovë, tani me banim në fshatin L., Komuna e Gjakovës, i martuar, baba i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar- shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 30.04.2016, rreth orës 13:00 minuta në Gjakovë, duke lëvizë në rrugën “S. S.” respektivisht kur arrin përball furrës së bukës “A.” gjer sa ka qenë duke e ngasur automjetin e markës “Jaguar-Stype” me targa të regjistrimit..., ngjyrë hiri, nga pakujdesia e në kundërshtim me rregullat e përgjithshme të komunikacionit rrugor bën kthim të pasigurve djathtas me qëllim të hyjë në një rrugicë duke mos i dhënë përparësi këmbësorës-të dëmtuarës Z. D. e cila mbante për dore vajzën e saj të vogël K. D., 5 vjeçare dhe në atë moment ishte kyçur në rrugë nga trotuari i anës së djathtë të cilën e godet me pjesën e pasme të anës së majtë ndërsa nga ky aksident përveç dëmeve materiale të pësuar në automjet, lëndime të lehta trupore pëson e dëmtuara Z. D., sipas mendimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr. F. D. të datës 29.08.2016.

Me këto veprime ka kryer veprën penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 41, 42, 43, 45, 46, 73, dhe nenit 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200 (dyqindën) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, gjykata do ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, duke ia llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzet) Euro.

Detyrohet i akuzuari U. K., që ti paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë: për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 20 Euro, për ekspertizën e komunikacionit shumë prej 40.88 Euro si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 40 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën me numër PP.nr.600/2016, të datës 21.09.2016, kundër të akuzuarit U. K., nga fshati L., Komuna e Gjakovës, ku fillimisht të njëjtin e ka akuzuar për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.7 lidhur me par.6 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se në aktakuzë është dhënë kualifikimi juridik nga neni 378 par.7 lidhur me par. 6 të KPRK-së por edhe pas bisedës me të dëmtuarën shoh që dëmi nuk e tejkalon shumë 15.000 (pesëdhjetëmijë) Euro, andaj për këtë arsye bëjë rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.7 lidhur me par.6 të KPRK-së, e ri kualifikoje në veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar. Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës dhe rikualifikimit të bërë kundër të akuzuarit U. K., andaj ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari U. K., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas pikave të aktakuzës dhe se është penduar për rastin e ndodhur dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla do të jetë më i kujdesshëm.

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, duke dhënë mendimin rreth pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka deklaruar se nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe provat dhe në faktet që janë bashkangjitur aktakuzës.

E dëmtuara Z. D., duke dhënë mendimin rreth pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka deklaruar se unë nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit por si e dëmtuar në këtë rast nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, dhe nuk kërkoj që i njëjti të dënohet dhe se si e dëmtuar nuk parashtroi kërkesë pasurore-juridike meqenëse në tërësi jam kompensuar nga ana e Kompanisë së Sigurimeve të automjetit të këtu të akuzuarit.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari U. K., me datë 30.04.2016, rreth orës 13:00 minuta në Gjakovë, duke lëvizë në rrugën "S. S." respektivisht kur arrin përball furrës së bukës "A." gjer sa ka qenë duke e ngas automjetin e markës "Jaguar-Stype" me targa të regjistrimit..., ngjyrë hiri, nga pakujdesia e në kundërshtim me rregullat e përgjithshme të komunikacionit rrugor bën kthim të pasigurte djathtas me qëllim të hyjë në një rrugicë duke mos i dhënë përparësi këmbësorës-të dëmtuarës Z. D. e cila mbante për dore vajzën e saj të vogël K. D., 5 vjeçare dhe në atë moment ishte kyçur në rrugë nga trotuari i anës së djathtë të cilën e godet me pjesën e pasme të anës së majtë ndërsa nga ky aksident përveç dëmeve materiale të pësuar në automjet, lëndime të lehta trupore pëson e dëmtuara Z. D., sipas mendimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr. F. D. të datës 29.08.2016.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është

bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e paraparë në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: se është baba i dy fëmijëve, është i gjendje së dobët ekonomike, i pa punë, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, fakti se pala e dëmtuar nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale si dhe faktin se i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së dhe se dënimi si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Gjykata nuk e udhëzoi të dëmtuarën Z. D., në kontest të rregullt pasurore-juridike për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, pasi që gjatë shqyrtimit fillestar e njëjta ka deklaruar se si palë e dëmtuar nuk parashtrijë kërkesë pasurore-juridike meqenëse në tërësi jam kompensuar nga ana e Kompanisë së Sigurimeve të automjetit të këtu të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.570/16, me datë 24.04.2017

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.